



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA DURRËS  
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr.121, datë 24.12.2020

PËR

**VIJIMIN E PROÇEDURAVE TË PRISHJES SË DETYRUAR TË 1 (NJË) OBJEKTI BANIMI, PRONË PRIVATE (PALLAT), NDODHUR NË NJËSINË ADMINISTRATIVE NR.4, DURRËS, NË ZBATIM TË EKSPERTIZËS SË THELLUAR TË HARTUAR NGA INSTITUTI I NDËRTIMIT, TIRANË**

Në zbatim të Ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjit nr. 45/2019, “Për mbrojtjen civile”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.750, datë 27.11.2019 “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë”, i ndryshuar, Aktit Normativ nr.9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore” miratuar me Ligjin nr. 97/2019, VKM nr. 887, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurës së përshpejtuar për hartimin dhe miratimin e planit të detyruar vendor, si dhe procedurës së miratimit të lejeve të zhvillimit/ndërtimit, në rastet e fatkeqësive natyrore”, dhe sipas relacionit të hartuar nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, me propozim të Zëvendëskryetares së Bashkisë, e cila kryen funksionet e Kryetares së Bashkisë,

**KËSHILLI BASHKIAK  
V E N D O S I :**

1. Vijimin e procedurës të prishjes së detyruar të 1 (një) objekti banimi, pronë private (pallat), të ndodhur në Njësinë Administrative nr. 4, Durrës, në zbatim të ekspertizës së thelluar të hartuara nga Instituti i Ndërtimit Tiranë, sipas tabelës si me poshtë vijon.

NR.	PROT/DATË	OBJEKTI	Nr. KATI	ADRESA	GIS	KONKLUZIONI	NJËSIA ADMINISTRATIVE
1.	PROT.11873/13 DATA 21.10.2020, NR.PROT. INST.2506/1, DATA 19.10.2020	PALLATI NR.344	5 KATE	Rr: "A.Goga", Durrës, Pallati nr.344	16559	PRISHJE	NJ.AD NR.4

- Zëvendëskryetari i Bashkisë, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit dhe Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit ndjekin procedurat për aplikimin, shqyrtimin dhe miratimin e dokumentit për leje ndërtimi (prishjen e objektit të dëmtuar nga fatkeqësia natyrore), sipas parashikimeve të vendimit nr. 887/2019, të Këshillit të Ministrave.
- Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit merr të gjitha masat për ndërhyrjen dhe prishjen e objektit të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi.
- Me qëllim njoftimin e banorëve dhe palëve të interesuara, vendimi publikohet në faqen zyrtare të Bashkisë Durrës, si dhe afishohet në "Këndin e Njoftimeve" pranë Njesisë Administrative nr. 4.
- Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Zëvendëskryetari i Bashkisë, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor Durrës dhe Drejtoria e Kabinetit.
- Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar).

### KRYETARI KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmish



U shpall sot me datë 24.12.2020



LISTA E PALLATEVE PER PRISHJE NJESIA ADMINISTRATIVE 4

Nr.	NJESHA / RAJONI NR. KATI	ADRESA	KODI GIS	PRISHJE/RIFORCIM	ZNKADASTRALE	NR.PAS	SIPANJOLLA / m2	NR.FAMILJE	AP. 3+1	AP. 2+1	AP. 1+1	PRODATE
-----	--------------------------	--------	----------	------------------	--------------	--------	-----------------	------------	---------	---------	---------	---------

**R-4**

RAJONI 4	5 KT	344/ALEKSANDER GOGA	16559	PER TU PRISHUR	851	2287	281					
----------	------	---------------------	-------	----------------	-----	------	-----	--	--	--	--	--



**VARREZAT**




REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 1103 prot.

Durrës, më 30.12.2020

**Lënda:** Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK  
DURRËS**



Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.121, datë 24.12.2020

“Për vijimin e procedurave të prishjes së detyruar të 1 (një) objekti banimi, pronë private (pallat), ndodhur në njësinë administrative nr.4, durrës, në zbatim të ekspertizës së thelluar të hartuar nga instituti i ndërtimit, Tiranë”.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

**PREFEKTI**

**ROLAND NASTO**

